



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.217, datë 18.06.2020

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z.{...}
TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË
GJYKATËN E LARTË, PËR NJË POZICION TË LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS
ADMINISTRATIVE DHE PËR DY POZICIONE TË LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS
CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR.82, NR.85 DHE NR. 86, DATË
26.02.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VJIMIN E PROCEDURËS
SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të tij nr. 82, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative”, si dhe nr. 85 dhe nr.86, datë 26.02.2020, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i saj, z.Illir Toska,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësisimit nga kandidati z.{...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.85 dhe nr.86, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vjimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës administrative dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.85 dhe nr.86, datë 26.02.2020.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR